REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opstine/Mayor"s Office

Data/Datum/Date:	**06/10/2026**
Nr./Br./No	02/1125
Për/Za/To:	**Muhadin Halili,Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit**
Përmes/Preko/Through:	**Zyrës së Kryetarit**
Nga/Od/From:	**Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës**
Lënda/Predmet/Subject :	Aprovim

Sipas Nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe neni 9.1 germa k. e Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik

V E N D I M

Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave per aktivitetin e prokurimit:

Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve për institucionet e komunës së Shtimes – Kontratë kornizë 24 muaj

1. Arbër Vishisella	**Kryetar i Komisionit**
2. Kaltrina Pajaziti	**Anëtare**
3.Mursel Salihu	**Anëtar**

1. Anëtarët e komisionit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërise siç janë specifikuar per anetarët e stafit të Prokurimit ne Nenin 23.3 të LPP-së, dhe do të nënshkruajne deklaratën me shkrim.

2. Anëtarët e komisionit i nënshtrohen dispozitave të Nenit 11 të L.PP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete te biznesit.

3. Secili anëtar do të nënshkruaj Deklaratën nen Betim duke perdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP "Deklaratën nën Betim" qe deklaron që ai/ajo do të kryej detyrën e vlerësimin në përgjegjësi të plotë dhe në pajtim me LPP.

4. Komisioni do të funksionoi nga dita e miratimit të vendimit për krijimin e komisionit deri në permbushjen e të gjitha detyrave të percaktuara nga autoritetit kontraktues, me shkrim, ose deri ne vendimin për ndërprerjen e procedures së prokurimit.

5. Procesi i vlëresimit të tenderit do të filloje menjëherë pas pranimit te këtij vendimi.

6. Komisioni do te beje ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do te
kryhet brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 dite nga hapja e ofertave.

7. Komisioni do te marr vendimet e tij në takime me votë të thjeshtë të shumicës, me votim të hapur. Procesi i votimit do të registrohet ne procesverbal.

8. Komisioni, në fund të detyrës së tij, do të përgatit një rekomandim për Zyrtarin Përgjegjës te Prokurimit së bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe nje
deklaratë të arsyeve mbështetëse për rekomandimin.

9. Vendimi përfundimtarë për dhënien e kontratës mbetet përgiegjësi e Zyrtarit
Përgjegjës për Prokurim. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit mund të pranoj
rekomandimin e komisionit ose të refuzoj atë. Nëse rekomandimi i komisionit refuzohet, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do të -shpjegoj me shkrim arsyet.
Shpjegimi i tillë do të përfshihet në të dhënat e procedurës së aktivitetit të prokurimit. Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues do të informohet menjëherë për refuzim te tille.

10. Në rast se një anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstaton se ai / ajo ka nje konflikt interesi në veresimin e tenderit, ai / ajo duhet te deklarojë interesin e tij / saj në tender dhe të lëshoj takimin dhe nuk do të marrin pjesë më tej në procesin e vlerësimit. Individi, i cili nuk merr pjesë më në vlerësim, konsiderohet edhe më tutje si i betuar per konfidencialitet.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dorëzohet:

1. Zyrës se Kryetarit;
2. Drejtorisë së Prokurimit.